




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.51/2024
Datë: 22 shkurt 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 4 të Rregullores Nr. 01/2022 për Themelimin e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore, në mbledhjen 321-të, të mbajtur më datë 22 shkurt 2024, merr këtë:

V E N D I M

- I. Lumni Sallauka dhe Halide Reka, gjyqtar në Gjykatën e Apelit, rizgjedhen edhe për një mandat tre (3) vjeçar, si anëtarë të Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore.
- II. Ndryshohet pika II, e dispozitivit të vendimit KGJK.nr.139/2022, i datës 13 prill 2022, ashtu që në vend të gjyqtarës Snezhana Mihajlovic, caktohet Edije Sezairi, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren, anëtare e Komitetit.
- III. Znj.Edije Sezairi ka mandat tre (3) vjeçar dhe fillon nga data 22 shkurt 2024
- IV. Vendimi hyn në fuqi me datë 22 shkurt 2024.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në takimin 321-të të mbajtur më 22 shkurt 2024, sipas detyrës zyrtare dhe duke u bazuar në nenin 4, paragrafi 3, të Rregullores Nr. 01/2022 për Themelimin e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore, në të cilën është përcaktuar se “ Mandati i anëtarëve të Komitetit është tre (3) vjeçar me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat tjetër”, dhe duke e marrë parasysh se anëtarëve aktual të Komitetit gjyqtarëve Lumni Sallauka dhe Halide Reka, ju ka skaduar mandati dy (2) vjeçar nga data 21 janar 2024, shqyrtoi mundësin e vazhimit të mandatit.

KGJK, pasi vlerësoi angazhimin dhe përkushtimin e anëtarëve të Komitetit z.Lumni Sallauka dhe znj.Halide Reka, vendosi që të njëjtëve të ju vazhdohet mandati edhe për një periudhë tre (3) vjeçare.

Po ashtu, KGJK për shkak të daljes në pension të gjyqtares Snezhana Mihajlovic, e cika ka qenë edhe anëtare e Komitetit, vendosi që në vend të saj caktoj gjyqtaren e Gjykatës Themelore në Prizren Edije Sezairi.

Nga se u tha si më lart u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtarëve të komitetit;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.